

KËNGA I

Bota kish ndërruar lisa,
uji i ri në det
kaltëronte n'ditn' e re;
por lumbardha e Anakreontit
Në Temp rronte e moçme.
Nd'uj një dit' vate te mali
e s'u kthye si e kish zakon.
Veç që atë s'e thau bora,
s'e përgjaku heshtëza,
por u largua gjersa ra
tek e bardha shpia ime.
Kur n'agim tokë edhe shpi
u zbuluan bashk' me detin,
si hareja që del sysh,
më zgjoi duke fërfëlluar
qelqeve t'dritares.
U patakso e ruajta jashtë:

rrusht' pak aguridhe,
dheut tonë i kishin hie;
lule liu të hapura,
n'i tund era e i përzien,
në atë ninull qeshin;
si ato lule-qielli.
Ti vështroje dhe s'kujtoje
asnjë mbëhi njerëzish.
Kallëzoret nëpër duajt
po këndonin. Dheut huaj
ahere ndër time motra
kisha arritur; mëma ime
emrin tim thosh nëpër shpi.
Një hare më rodhi kurmit,
si hareja kur te shtrati
mbrëmanet, vajza e ngrohtë
ndien për të parëzën
sisët që m'i fryhen.

Vargjet ku shprehet ripërtëritja e natyrës:

Bota kish ndërruar lisa,
uji i ri në det
kaltëronte n'ditn' e re;

Vargjet ku shprehet frymëzimi poetik:

por lumbardha e Anakreontit
Në Temp rronte e moçme.
Nd'uj një dit' vate te mali
e s'u kthye si e kish zakon.
Veç që atë s'e thau bora,
s'e përgjaku heshtëza,
por u largua gjersa ra
tek e bardha shpia ime.
Kur n'agim tokë edhe shpi
u zbuluan bashk' me detin,
si hareja që del sysh,
më zgjoi duke fërfëlluar
qelqeve t'dritares.

Vargjet ku shprehet stina e pranverës:

U pataksha e ruajta jashtë:
rrusht' pak aguridhe,
dheut tonë i kishin hie;
lule liu të hapura,
n'i tund era e i përzien,
në atë ninull qeshin;
si ato lule-qielli.
Ti vështroje dhe s'kujtoje
asnjë mbëhi njerëzish.

Vargjet që shprehin kthimin e poetit në mjedisin familjar:

Kallëzoret nëpër duajt
po këndonin. Dheut huaj
ahere ndër time motra

kisha arritur; mëma ime
emrin tim thosh nëpër shpi.
Një hare më rodhi kurmit,
si hareja kur te shtrati
mbrëmanet, vajza e ngrohtë
ndien për të parëzën
sisët që m'i fryhen.

KËNGA V

Përse të venë në det
mendimet, zemëra ime?
Zbardhuan anijeat
panë këndeje e u fshehën..
Erdhi dita e Arbërit!
Doemos do vdesim
në shtrat. Në mos rënçim
përpara shtëpive tona
e nën dhe do na harrojnë
shokët e vëllezërit
krojet e katundi ynë.
Tani që nata e zezë
me shiun e saj të butë

kudo i përbalti udhët,
hapnie ju derën
tek të përhedhurat çupa
lozin të harruara.
Vasha forëmadhja
ma rrëmbet' nga dora
atë buzëhieshmen
e ma sjelltë mua përpara.
Kanë për t'iu ndezur faqet
me atë shenjzën në mes.
kur e ndrojtur të më qeshë,
Veç në sy të shihemi,
Pa dhe bota të përmbysset.

Mjetet stilistikore:

- Përse të venë në det mendimet, zemëra ime?- Pyetje retorike, metaforë
- Zbardhuan anijeat panë këndeje e u fshehën- Metaforë, metonimi, kontrast

- Erdhi dita e Arbërit!- Thirror
- e nën dhe do na harrojnë shokët e vëllezërit krojet e katundi ynë- Enumeracion, polisindetë
- nata e zezë- Epitet metaforik
- shiu i butë- Epitet
- nata i përbalti udhët- Metaforë
- dera- Simbol
- të përhedhurat çupa- Inversion, epitet
- lozin të harruara- Epitet
- vasha forëmadhja- Epitet
- atë buzëhieshmen- Epitet
- Kanë për t'iu ndezur faqet- Metaforë
- e ndrojtur- Epitet
- bota të përmbysët- Metaforë
- Është përdorur, gjithashtu, antiteza mes pjesës së parë dhe të dytë të këngës

KËNGA XXX

Fryjti era e maleve
dhe rrëzoi hien e lisit.
Gjaku im te Lumi i Vodhit.
Hapeni shatoren,
o ushtarë, që të shoh
Shkodrën edhe time motër
te dritarja kundruall.

Atje nuk do zgjohem më
luleve që i tund era
si suvalë e pasosur.
Mblidhen shokët mbrëmanet
në katund, në vatërat.-
I lashë si ëndërrëz.

.....

KOMENT

Kënga XXX është kënga e fundit e poemës “Këngët e Milosaos”. Ajo pasqyron momentet e fundit të jetës të Milosaos të plagosur në luftë, duke mbrojtur Shkodrën. Vihet re se poema nis me stinën e pranverës, simbol i energjisë dhe forcës rinore të jetës së njeriut dhe përfundon me dimrin, simbol i venitjes dhe fundit të saj.

Si një poet romantik, De Rada i frymëzuar nga natyra, përdor lirin si fjalë kyç. Si fillim për të shprehur ripërtëritjen e jetës nëpërmjet tij e më pas ardhjen e dimrit, që sjell vdekjen. Qysh në fillim të vargjeve, kjo është e shprehur me anë të paralelizmit figurativ dhe metaforës. Më tej, poeti ka përdorur figurën e elipsit për të dhënë një mendim më të ngjeshur dhe për të përshpejtuar ritmin e ngjarjes dhe të ndjenjave të tij.

Fjalët e fundit të Milosaos janë të mbushura me mall e nostalgji për jetën, që la pas dhe për vendlindjen e tij. Në këtë pikë, fati i heroit përkon me fatin e arbëreshëve të përmalluar e të brengosur për atdheun e tyre. Dhe në vargun e fundit, ai thekson pikëpamjet e tij për jetën, e cila është e lidhur me vendlindjen, kuptimi i së cilës arrihet, kur ke lënë gjurmë pozitive; me jetën që është një iluzion dhe ia vlen të jetohej, me jetën e cila e merr kuptimin, kur dhimbja dhe lumturia jetojnë së bashku.